



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

09/24/2026

23-02-2026

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Prishtinë
Njoftimi nr. 09/24/2026
23.02.2026

Në bazë të nenit 32 dhe 33 të Ligjit Nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-007 për Procedurën jokontestimore, si dhe nenit 21 paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 11/2024 për procedurën e Rindërtimit të Kadastrit, Komisioni për Rindërtim të Kadastrit, përmes Nënkomisionit, publikon këtë:

**NJOFTIM PËR FILLIMIN E PROCEDURËS TRASHËGIMORE
NË PROCEDURËN E RINDËRTIMIT TË KADASTRIT**

Në projektin për Rindërtim të Kadastrit ka filluar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënësve të listuar në listën e bashkëngjitur me këtë njoftim. Kjo listë përmban të dhënat për trashëgimlënësin, trashëgimtarët potencial, Zonën Kadastrale dhe Komunën.

Njoftohen dhe ftohen trashëgimtarët e mundshëm që nuk janë përfshirë në listën e bashkëngjitur me këtë njoftim, dhe palët e tjera me interes që brenda afatit 30 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të lajmërohen në zyrën e Operatorit Ekonomik në Zonën Kadastrale të përfshirë në rindërtim, çdo ditë pune nga ora 09.00 - 16.00, me qëllim të njoftimit me të drejtat e tyre trashëgimore.

Ky njoftim mbetet i hapur për periudhën 30 (tridhjetë) ditore, duke filluar nga dita e publikimit. Gjithashtu, njoftoheni se me trashëgimtarët potencial do të mbahet Seanca informuese pas përfundimit të afatit 30 ditor, me qëllim të njoftimit me të drejtat dhe detyrimet e tyre. Për ditën dhe orën e saktë palët do të njoftohen me kohë.

Bashkëngjitur është lista e trashëgimlënësve dhe trashëgimtarëve potencial.

Për çdo informacion shtesë në lidhje me këtë njoftim, mund të kontaktoni Zyrën e Operatorit Ekonomik në e-mail adresën: geoproject@gmail.com +383 219 618, , dhe numrat kontaktues:

Kryesuesi i nënkomisionit,
Xhevat Azemi

Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale, Lot 4

Lista me të dhënat për rastet e shqyrtimit të trashëgimisë

Nr. R.	Trashëgimlanësi	Trashëgimtarët simbas dëshmisë së vdekjes	Zona	Komuna
1	Selmon (Mehmet) Gashi	Ajshe (Selmon) Pllana Shukri (Selmon) Pllana Ferkije (Selmon) Pllana Maliqe (Selmon) Megjuani	Breznicë	Obiliq
2	Zenel (Rustem) Bekolli	Sabit Bekolli Bahtije Behrami Elfete Bekolli Mihane Hetemi Adiat Bekolli Hana Bekolli Azemi Vlora Dragusha Albana Bekolli Tullari Zineta Bekolli Kevser Bekolli Velide Bekolli Giltene Bekolli Hizri Bekolli Shemsije Bekolli Fikrete Bekolli Suade Bekolli	Vranidoll	Prishtinë
3	Arife (Rexhep) Gashi	Brahim Gashi	Janjevë	Lipjan
4	Radovan (Cvetko) Arsić	Stana Popović Srdjan Arsić Ivica Arsić Miloš Arsić	Kufce e Eperme	Novoberdë
5	Ismajl (Xhemajl) Gashi	Të publikuara Kadri Gashi Shtese Rabije Berisha Mevlude Kaçiu	Breznicë	Obiliq

		Xhevrije Berisha Sadije Paci		
6	Xhemajl (Hajdar) Gashi	<i>Të publikuara</i> Ekrem Gashi Nexhmedin Gashi Bahri Gashi Bastri Gashi Hysni Gashi Hilmi Gashi Ali Gashi Xhevdet Gashi Shemsi Gashi Shtesë Kadri Gashi Sanije Reçica Fikrije Sejdiu Anife Ballazhi Gjyla Bllaca Bedrije Murati	Breznicë	Obiliq

Informata shpjeguese për të drejtat e trashëgimtarëve sipas ligjit

Kjo informatë lëshohet në pajtim me nenin 32 të Ligjit Nr. 06/L-007 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 030-007 për Procedurën jokontestimore. Legjislacioni që rregullon trashëgiminë në Kosovë përcakton se:

- Dëshmia e vdekjes është e domosdoshme për të filluar procesin e trashëgimisë.
- Dëshmitë e vdekjes lëshohen nga zyra e Gjendjes Civile sipas të dhënave nga Regjistri Civil.
- Të drejtë të shqyrtojnë rastet e trashëgimisë jokontestimore kanë gjykata, noteri apo institucioni i përcaktuar me ligj të veçantë

- Njoftimet për seancat e trashëgimisë që zhvillohen publikohen në Portalin për të drejtat pronësore në Gazetën Zyrtare. Njoftimi do të qëndrojë aty për tridhjetë (30) ditë para se të fillojë procedura e trashëgimisë.
- Para se të fillojë procedura e trashëgimisë, mbahet një seancë informuese për të gjithë trashëgimtarët/et, për t'i njoftuar ata/ato me të drejtat e tyre në trashëgimi. Çdo trashëgimtarë që nuk merr pjesë në seancë informuese do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në seancë informuese përveç nëse ai trashëgimtar ka dërguar deklaratë të vërtetuar.
- Për rastet e trashëgimisë kur trashëgimtari/ja ka vdekur dhjetë (10) vite e më shumë para fillimit të procedurës trashëgimore, secili trashëgimtar/e që dëshiron të kërkojë pjesën e tij/saj të trashëgimisë, për të ruajtur të drejtën që ka për të trashëguar, duhet të dërgojë organi që zhvillon procedurën e trashëgimisë një deklaratë të noterizuar që vërteton se trashëgimtari/ja do të kërkojë pjesën e tij/saj të trashëgimisë dhe do të marrë pjesë në seancën informuese.
- Për rastet e trashëgimisë kur trashëgimtari/ja ka vdekur jo më shumë se dhjetë (10) vite para fillimit të procedurës trashëgimore, konsiderohet se secili trashëgimtar/e (paraqitur apo jo) do vazhdon të mbrojtë/dëshmojë të drejtat e tij/saj në trashëgimi.
- Çdo trashëgimtar/e mund të konfirmoj përmes deklaratës së noterizuar se i kupton të drejtat dhe obligimet e tij/saj si trashëgimtar/e; dhe atë se trashëgimtari/ja dëshiron të heq dorë nga prezenca në procedurën trashëgimore, përfshirë seancën informuese.
- Fshehja e trashëgimtarëve/eve është e kundërligjshme. Trashëgimtarët/et e identifikuar/a kanë për detyrë të informojnë organin që zhvillon procedurën e trashëgimisë për ndonjë trashëgimtar/e të mundshëm/me të paidentifikuar, për të cilët ata/ato janë në dijeni. Trashëgimtarët/et e identifikuar/a duhet gjithashtu t'i ofrojnë të gjitha informatat që ata/ato kanë në lidhje me vendndodhjen e trashëgimtarëve/eve të mundshëm/me, të cilët/cilat nuk mund të gjenden.
- Ushtrimi i presionit mbi trashëgimtarin/ën për të hequr dorë nga pjesa e tij/saj e trashëgimisë është i kundërligjshëm.
- Heqja dorë nga trashëgimia është e përhershme. Ajo nuk mund të revokohet më vonë. Deklarata e heqjes dorë e ndonjë trashëgimtar/eje nga pjesa e tij/saj bëhet me procesverbal.
- Kur ndonjëri/a nga trashëgimtarët/et deklarohet për të hequr dorë nga pjesa e tij/saj e trashëgimisë, organi që zhvillon procedurën e trashëgimisë do të mbajë një bisedë me atë trashëgimtar/e për tu siguruar që:
 - *Trashëgimtari/ja i di të drejtat e tij/saj;*
 - *Trashëgimtari/ja nuk është vënë në presion që të heq dorë kundër vullnetit të tij/saj;*
 - *Trashëgimtari/ja është në dijeni që heqja dorë nuk mund të tërhiqet pasi të bëhet;*

- Nëse organi që zhvillon procedurën e trashëgimisë është vënë në dijeni se një trashëgimtar/e është nën presion për të hequr dorë nga trashëgimia e tij/saj, heqja dorë nuk pranohet, dhe çështja referohet tek prokurori i shtetit.
- Pasi që aktvendimi për trashëgiminë të bëhet i formës së prerë, bëhet regjistrimi në regjistrat e pronës së paluajtshme, sipas legjislacionit në fuqi.
- Partnerët që bashkëjetojnë mund të trashëgojnë nga njëri-tjetri si bashkëshortë nëse bashkësia e tyre jashtëmartesore zgjat deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit/ses, dhe ka zgjatur të paktën pesë (5) vite; dhe të paktën tri (3) vite nëse nga kjo marrëdhënie kanë lindur fëmijë.
- Në qoftë se trashëgimtarët janë të mitur, për heqjen dorë nga trashëgimia, nevojitet lejen e organit të kujdestarisë.